Pranuar 20/06/2022
Nj. org. Numër
06 192

RAPORT I KOMISIONIT VLERËSUES PËR ANGAZHIMIN E BASHKËPUNËTORËVE TË JASHTËM

Fakulteti: Bujqesise dhe Veterinarise

Lëndët: Bazat e Hulumtimit Shkencor, Shkencat e Informimit dhe Komunikimit, Zhvillimi i Projekteve, Inxhinieria në Teknologjinë Ushqimore, Vetitë strukturore, Teknikat e Përpunimit Matjeve dhe Automatizimit, Aditivët Ushqimor

Kandidatët e paraqitur: Kaltrina Berisha, Era Isufi

Bazuar në Rregulloren e procedurave vlerësuese për angazhimin e bashkëpunëtoreve të jashtëm në UPHP nr. 1/95 të datës 24.06.2021, dhe të vendimit 06/142 (dt. 16.06.2022) të Këshillit të Fakultetit të Bujqësisë dhe Veterinarisë në seancën e mbajtur me 05.07.2021, është caktuar

Komisioni vlerësues

1. Kryetar	Prof. Dr Hysen Bytyçi, UPHP-Fakultetit të Bujqësisë dhe Veterinarisë
2. Anëtar	Prof. Asoc. Dr Mentor Thaqi, UPHP-Fakultetit të Bujqësisë dhe Veterinarisë
3. Anëtar	Prof. Ass. Dr Arbenita Hasani, UPHP-Fakultetit të Bujqësisë dhe Veterinarisë

Dokumente relevante:

Nenet 76, pika 1,2 173 dhe 174 të Statutit të Universitetit të Prishtinës dhe neni 6 i Rregullores se procedurave vlerësuese për angazhimin e bashkëpunëtoreve të jashtëm në UPHP - Rregullorja e procedurave vlerësuese për angazhimin e bashkëpunëtoreve të jashtëm nr. 1/95 të datës 24.06.2021.

SHËNIMET PËRMBLEDHËSE TË KANDIDATËVE

Vlerësimi i kandidateve

1. Kandidatja Msc. Kaltrina Berisha ka lindur me 20.05.1995 në Vasilevë, Gllogoc. Ka të përfunduar nivelin Bachelor në Fakultetit të Bujqësisë dhe Veterinarisë të Universitetit të Prishtinës, drejtimi Teknologji Ushqimore me Bioteknologji dhe studimet master në Szent Istvan University në Godollo - Hungari. Kandidatja Kaltrina Berisha, ka arritur note mesatare gjate studimeve 9.45 (Bsc) respektivisht 9.96 (Msc). Kandidatja ka të regjistruar në vitin 2018 studimet e Doktoratës në "Shkencat e Ushqimit /Food Science" në Universitetin Hungarez të Shkencave të Bujqësisë dhe Jetës (Hungarian University of Agriculture and Life Sciences), Budapest në Hungari. Kandidatja Kaltrina Berisha ka të publikuar si autore pesë punime shkencore dhe tre punim si koautore si dhe ka njëmbëdhjetë abstrakte në konferencat kombëtare dhe ndërkombëtare. Ajo, gjithashtu ka përvojë pune si asistente e angazhuar për 4 vite në Universitetin e Prishtinës, dhe përvojë akademike në Universitetin Hungarez të Shkencave të Bujqësisë dhe Jetës.
   Bazuar në dokumentacionin e prezantuar nga kandidatja, si dhe në bazë të Rregullores të UP-së 2/475, komisioni në përbërje të plot vlerëson se kandidatja Kaltrina Berisha i ka të kryera studimet në fushën përkatëse, Bsc. Teknologji Ushqimore me Bioteknologji, ndërsa Msc. Bioteknologji Bujqësore. Kandidatja, edhe

pse në moshe të re ka një aktivitetet të theksuar shkencor dhe hulumtues. Gjithashtu, ajo ka të regjistruar në vitin 2018 studimet e Doktoratës në "Shkencat e Ushqimit /Food Science" në ne Universitetin Hungarez të Shkencave të Bujqësisë dhe Jetës, Budapest në Hungari, dhe është në fazën finale të përfundimit të doktoratës.

2. Kandidatja Msc Era Isufi ka lindur me 28.06.1997 në Peran, Podujevë. Ka përfunduar studimet në nivelin "bachelor" në Fakultetin e Bujqësisë dhe Veterinarisë të Universitetit të Prishtinës, drejtimi Teknologji Ushqimore me Bioteknlogji, duke realizuar notë mesatare 9.07 (nga maksimum 10.00). Gjithashtu, kandidatja ka të përfunduar studimet "master" në Universitetin Debrecen – Hungari, pran Fakultetit të Bujqësisë, Shkencat e Ushqimit dhe Menaxhimi i Mjedisit , drejtimi "Inxhinieri të Sigurisë dhe Cilësisë se Ushqimit", ku ka arritur note mesatare 4.95 (nga maksimum 5.00).

   Bazuar në dokumentacionin e dorëzuar dhe vlerësuar nga Komisioni përkatës, Msc. Era Isufi plotëson kushtet e parapara me konkursin gjegjes sa i përket: moshës, notes mesatare të arritur gjate studimeve në dy nivelet (bachleor dhe master), si dhe fushës përkatëse të studimeve relevante për pozitën që ka aplikuar (numri rendor 14 sipas konkursit).

UNIVERSITETI I PRISHTINËS "HASAN PRISHTINA"
Raport i Komisionit vlerësues për angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm

Tabela e vlerësimit të kandidateve:

Nr.	Emri dhe mbiemri	Grada shkencore	Aplikohet për bashkëpunëtorët e jashtëm për ligjërata			Aplikohet për bashkëpunëtorët e jashtëm për ushtrime			Mosha (datëlindja)	Përvoja e punës në fushën përkatëse (vitet)	Bie ndesh me Nenin 7, paragrafi 10, Rregullorja Nr. 1/95, e datës 24/06/2021 (PO/JO)	Propozohet të angazhohet (PO/JO)
			Thirrja akademike	Publikimet në revista shkencore ndërkombëtare, në përputhje me kriteret e Statutit dhe Rregulloren në fuqi për emërimin e personelit akademik	Përvoja e punës profesionale në mjekësinë terciare (Fakulteti i Mjekësisë)	Nota Ba.	Nota Ma.	Specializimi për lëndët klinike në Fakultetin e				
1	Kaltrina Berisha	MSc	/	8	/	9.45	9.96	/	20.05. 1995	4	Jo	Po
2	Era Isufi	Msc	/	0	/	9.07	4.95 (max 5.00)	/	28.06. 1997	/	Jo	Jo

REKOMANDIM

Bazuar në këtë që u prezantua me lartë, Komisioni vlerësues në përbërje të plotë konstaton se nga dy kandidatet e paraqitura në konkursin e lartcekur, Msc. Kaltrina Berisha (PhD kandidate) ka cilësi më të larta shkencore e akademike dhe rrjedhimisht plotëson kushtet për zgjedhje në pozitën "bashkëpunëtore e jashtme" për mbajtjen e ushtrimeve në lendet: Bazat e Hulumtimit Shkencor; Shkencat e Informimit dhe Komunikimit; Zhvillimi i Projekteve; Inxhinieria në Teknologjinë Ushqimore' Vetitë strukturore dhe Teknikat e Përpunimit Matjeve dhe Automatizimit dhe Aditivët Ushqimor. Msc. Kaltrina Berisha, ka përvojë akademike në cilësinë e "Bashkëpunëtores se jashtme" tashme 4 vite pran Fakultetit të Bujqësie dhe Veterinarisë të Universitetit të Prishtinës, në lendet përkatëse apo të përafërta nga lemia e Teknologjisë Ushqimore dhe Shkencës se Ushqimit. Gjithashtu, kandidatja znj. Berisha që 4 vite ka qenë e angazhuar në fushën akademike (ligjëruese nënë mbikëqyrjen e profesorit të lëndës) në "Universitetin Hungarez të Shkencave të Bujqësisë dhe të Jetës – Hungarian University of Agriculture and Life Sciences", në fushat përkatëse të paraqitura në këtë konkurs. Kandidatja Berisha, është në fazën finale të përfundimit të studimeve të doktoratës me ç'rast gjate kësaj periudhe ka arritur të publikoj në cilësinë e autores se pare apo korrespondente punime shkencore të indeksuara në platformën "Scopus" dhe një mori pjesëmarrje në konferenca shkencore nga lemia e teknologjisë dhe shkencës se ushqimit.
Kandidatja Msc Era Isufi, përkundër cilësive të larta të arritur gjate studimeve në të dy nivelet (bachelor dhe master), si dhe eksperiencës profesionale pas përfundimit të studimeve, mbetet prapa kandidates së parë në sferën akademike dhe shkencore.

Si rrjedhojë, Komisioni Vlerësues rekomandon Këshillit të Fakultetit të Bujqësie dhe Veterinarisë të Universitetit të Prishtinës, që për lendet e sipërshënuara të përzgjedh në cilësinë e "bashkëpunëtores së jashtme" kandidaten Msc. Kaltrina Berisha.

Komisioni vlerësues:

Prishtinë: 20.06.2022

1. Kryetar — Prof. Dr Hysen Bytyçi, UPHP-Fakultetit të Bujqësisë dhe Veterinarisë

2. Anëtar — Prof. Asoc. Dr Mentor Thaqi, UPHP-Fakultetit të Bujqësisë dhe Veterinarisë

3. Anëtar — Prof. Ass. Dr Arbenita Hasani, UPHP-Fakultetit të Bujqësisë dhe Veterinarisë